

29,694

polica për sigurimin e sëmundjeve janë shitur gjatë muajit janar 2023.

# iSIGURIMET

Nr. #041 • mars 2023 • [www.bks-ks.com](http://www.bks-ks.com)

8,3 milionë euro dëme  
u paguan vetëm në  
muajin janar 2023


03



MAZREKU: STIKERSAT NDIKUAN  
POZITIVISHT NË SIGURINË NË  
TRAFIKUN RRUGOR

09

**42,000,000€**  
**U PAGUAN PËR 11 VJET PËR**  
**DEMET E SHKAKTUARA NGA**  
**AUTOMJETET E PASIGURUARA**



04

## Rritet për 56 % shitja e policave për sigurimin e sëmundjeve

Gjatë muajit janar të këtij viti shitja e policave për sigurimin e sëmundjeve është rritur për 56% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Duke iu referuar të dhënave zyrtare shihet se gjatë muajit janar të këtij viti janë shitur 29,694 polica për sigurimin e sëmundjeve, derisa në

periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë shitur 19,031 polica për sigurimin e sëmundjeve, e ku shihet një rritje prej 56 %.

**29,694**  
polica për sigurimin e sëmundjeve janë shitur gjatë muajit janar 2023.

**19,031**  
polica për sigurimin e sëmundjeve janë shitur gjatë muajit janar 2022.

**56.03%**  
është rritur shitja e policave për sigurimin e sëmundjeve gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin janar 2022.

## 33,146 polica TPL u shitën gjatë muajit janar

Sipas të dhënave zyrtarë të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se vetëm gjatë muajit janar të këtij viti kompanitë e sigurimeve në Kosovë kanë shitur 33,146 polica

TPL e brendshme, e nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjte të vitit paraprak shihet se shitja e policave gjatë muajit janar 2023 është më e lartë për 6,18 % në

raport me muajin janar 2022, ku sipas të dhënave zyrtare në atë muaj janë shitur 31 mijë e 217 polica TPL e brendshme.

**33,146**  
polica TPL e brendshme janë shitur gjatë muajit janar 2023.

**31,217**  
polica TPL e brendshme janë shitur gjatë muajit janar 2022.

**6.18%**  
është rritur shitja e policave TPL gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin janar 2022.

## 23,96 % është rritur shitja e policave TPL

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë muajit janar të këtij viti kompanitë e sigurimeve në vend

kanë arritur të shesin 6980 polica TPL Plus, nga 5631 sa i kishin shitur gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Nëse bëjmë një përlllogaritje shihet se

shitja e policave TPL Plus gjatë muajit janar është rritur për 23,96 % më shumë në raport me muajin janar të vitit që lamë pas.

**6,980**  
polica TPL Plus janë shitur gjatë muajit janar 2023

**5,631**  
polica TPL Plus janë shitur gjatë muajit janar 2022

**23.96%**  
është rritur shitja e policave TPL plus gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin janar 2022.

# 8,3 milionë euro dëme u paguan vetëm në muajin janar 2023

**Vetëm gjatë muajit janar 2023 kompanitë e sigurimeve të licencuara nga Banka Qendrore, si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë arritur të paguajnë hiç më pak se 8 milionë e 306 mijë euro për kompensim të dëmeve, apo 83,03 % më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Si asnjëherë më parë pagesa e dëmeve si nga kompanitë, ashtu edhe nga BKS-ja po kryhen në afate rekorde kohore.**

### ISIGURIME

Si asnjëherë më parë vetëm gjatë muajit janar të këtij viti, kompanitë e sigurimeve, si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit paguan hiç më pak se 8,306,119 në emër të kompensimit të dëmeve nga palët e dëmtuara si në aksidente komunikacioni, ashtu edhe trajtim të sëmundjeve të ndryshme të cilat i mbulon polica. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se muaji janar i këtij viti ka qenë rekord i pagesës së mjeteve për kompensim të dëmeve. Vetëm gjatë muajit janar 2023 kompanitë e sigurimeve të licencuara nga Banka Qendrore, si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë arritur të paguajnë hiç më pak se 8 milionë e 306 mijë euro për kompensim të dëmeve, apo 83,03 % më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

### 83 % U RRIUR PAGESA E DËMEVE

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se 14,763 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve si dhe BKS-ja vetëm gjatë muajit janar 2023. Nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shihet qartë se pagesa e dëmeve është rritur prej hiç më pak se 83 %. “Numri i dëmeve të paguara gjatë muajit janar 2023 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është rritur për 2,250 dëme duke arritur në 14,763, nga të cilat 14,739 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 24 nga kompanitë e sigurimit të Jetës”, thuhet në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës.

260 milionë për 5 vite dëme të paguara

Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gati gjysma e të hyrave totale të kompanive të sigurimeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve gjatë 5 viteve të fundit është shpenzuar për kompensim të dëmeve. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë kësaj peri-

udhe kohore vlera e primeve të shkuara ka qenë 539 milionë euro, derisa vlera e dëmeve të paguara 260 milionë euro. Në vitin 2018 sipas të dhënave të BQK-së shihet se vlera e Primeve të shkruara bruto ka qenë 92.1 milionë euro, derisa vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe BKS-ja ka qenë 42,9 milionë euro. Bazuar në këto të dhëna del se 46 % e të hyrave totale gjatë vitit 2018 janë shpenzuar vetëm për kompensim të dëmeve. Po ashtu, edhe gjatë vitit 2019 të hyrat totale të kompanive të sigurimeve nga Primet e shkruara Bruto kanë arritur në 99,2 milionë euro, derisa gjatë këtij viti në emër të dëmeve kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimeve kanë paguar hiç më pak se 47,9 milionë euro. Gjatë këtij viti shihet se mbi 48 % të hyrave totale të kompanive janë shpenzuar për kompensim të dëmeve për palë të dëmtuara.

### PAGESE REKORDE E DËMEVE

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, tregon se kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimit janë duke trajtuar shpejt dhe korrekt demet e raportuara nga palët e dëmtuara. Sipas tij, tashmë është prioritet i secilit drejtor të kompanive të sigurimit pagesa shumë e shpejtë e dëmeve për palët e dëmtuara si në rast kur kemi aksident komunikacioni, apo edhe për çështje tjera. “Ashtu siç kam thënë edhe më parë, po e përsëris edhe një herë. Demet janë duke u trajtuar shumë shpejt nga kompanitë e sigurimeve, janë duke u paguar shumë shpejt dhe kështu do të vazhdojë edhe në të ardhmen”, ka thënë drejtori Mazreku. Sipas tij, kohëve të fundit numri i rasteve që kanë përfunduar në Gjykatë si të pakënaqur me vlerësimin që ka bërë kompania, respektivisht BKS-ja, ka renë thuajse në pikën zero. Ai më tutje tregon se kanë për qëllim që sivjet ta ulin në zero numrin e rasteve që përfundojnë në Gjykatë.

**83%**

është rritur pagesa e dëmeve gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin janar 2022.

**14,763**

dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve si dhe BKS-ja vetëm gjatë muajit janar 2023.

**2,250**

është më i lartë numri i dëmeve të paguar gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin e njëjtë 2022.

**8,306,119€**

dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit vetëm gjatë muajit janar 2023.

# 42,000,000 € U PAGUAN PËR 11 VJET PËR DEMET E SHKAKTUARA NGA AUTOMJETET E PASIGURUARA

**ISIGURIME**

Gjatë 11 viteve të fundit Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) ka shpenzuar hiç më pak se 42 milionë euro për kompensim të dëmeve të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara në vend. Edhe më tutje numri i dëmeve të shkaktuara nga këto automjete vazhdon të jetë i madh pavarësisht përpjekjeve të mëdha për ta ndaluar këtë trend i cili në masë të mëdha dëmton kompanitë e sigurimeve në vendin tonë. Valon Berisha, drejtor Financiar në Byronë Kosovare të Sigurimit tregon viteve të fundit ka rënë numri i aksidenteve të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara, por sipas tij shuma e kompensuar vazhdon të jetë e lartë si për shkak të automjeteve të reja të përfshira në aksidente si për shkak të rritjes së madhe të kostos së riparimeve.

Më tutje drejtori Berisha tregon se falë një angazhimi të madhe, falë fushatave të mëdha sensibilizuese ka ndikuar që trendi mos të vazhdojë me ngritje siç ka qenë në vitet paraprakë, por të kthehet në ulje siç po ndodh tash.

“Gjatë vitit 2022 si Byro kemi organizuar debate, kampanja, kemi organizuar shumë takime me përfaqësues të Institucioneve ku qëllim i vetëm është angazhimi i përbashkët në uljen e numrit të automjeteve të paregjistruara në vend e që paraqet një barrë shumë të rëndë financiare për kompanitë e sigurimeve në vendin tonë” ka treguar më tutje drejtori Berisha.

**SHUMA E DËMEVE TË PAGUARA NDËR VITE**

Valon Berisha, drejtor Financiar në Byronë Kosovare të Sigurimit (BKS) tregon se në vitin 2012

shuma e dëmeve të paguara për demet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara ka qenë hiç më pak se 3,500,528 euro, derisa në vitin 2013 shuma e dëmeve të paguara për këtë qëllim ka qenë 3,756,892 euro. Po ashtu, më tutje drejtori Berisha tregon se në vitin 2014 shuma e mjeteve të paguara për aksidentet e shkaktuara nga automjetet pasiguruara ka qenë 2,793,902 euro, Derisa në vitin 2015 shuma e paguar ka qenë 3,229,362 euro. Më tutje sipas drejtorit Berisha në vitin 2016 shuma e dëmeve të paguara për aksidentet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara ka qenë 3,336,121 euro, Derisa në vitin 2017 sipas tij shuma e dëmeve të paguara për këtë qëllim ka qenë 3,328,898 euro. Edhe në vitin 2018 për këtë qëllim janë paguar 3,402,319 euro, e në vitin 2019 sipas tij janë paguar 4,436,611 euro.


Gjithnjë duke iu referuar drejtorit Financiar të Byrosë Kosovare të Sigurimit shihet se në vitin 2020 për demet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara shuma ka qenë 3,480,871, në vitin 2021 shuma e dëmeve të paguara ka qenë 5,649,422, derisa në vitin 2022 shuma e mjeteve të paguara për aksidentet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruar ka qenë 4,551,408.

**NUMRI I DËMEVE TË PAGUAR NDËR VITE**

Për sa i përket dëmeve të paguara në numër drejtori Berisha tregon se gjatë vitit 2012 Byroja Kosovare e Sigurimit i ka paguar 2139 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara, gjatë vitit 2013, sipas tij janë paguar 2,345 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara, në vitin 2014 janë paguar 1891 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara. Gjithashtu në vitin 2015 sipas drejtorit Berisha janë paguar 1447 dëme, Derisa në vitin 2016 janë paguar 1,547 dëme. Gjithashtu në vitin 2017 nga Byroja Kosovare e Sigurimit janë paguar 1993 dëme, Në vitin 2018 janë paguar

1,766 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara në vend. Më tutje Valon Berisha, drejtor Financiar në BKS-së tregon se në vitin 2019 nga Byroja janë paguar 1769 dëme, e në vitin 2020 janë paguar 1,600 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara në vend. Po ashtu edhe në vitin 2021 janë paguar 2740 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara, Derisa në vitin 2022 janë paguar 2,198 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara në vend.

## SHUMA E MJETEVE QË BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT KA SHPENZUAR PËR KOMPENSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA AUTOMJETET E PASIGURUARA.



## NUMRI I DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA AUTOMJETET E PASIGURUARA JANË KOMPENSUAR NGA BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT

# PËR 2 VITE 1,2 MILIONË EURO REGRESE U KTHYEN NË LLOGARI TË BKS-SË

Vetëm në dy vitet e fundit Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) përmes procedurave gjyqësore dhe përmes marrëveshjeve direkte ka arritur të kthejë hiç më pak se 1,2 milionë euro në emër të regreseve, pra dëme që BKS-ja i ka paguar kohë më parë për palët që janë dëmtuar nga personi i cili ka shkaktuar aksident komunikacioni me automjet të pasiguruar.

## ISIGURIME

Vetëm gjatë 11 viteve të fundit janë më shumë se 42 milionë euro që ka paguar Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) për dëmet që kanë shkaktuar në komunikacion automatet e pasiguruara. Por, në anën tjetër deri në fund të vitit 2020 në emër të regreseve në llogari të BKS-së janë kthyer vetëm 450 mijë euro, apo 1 % e shumës që Byroja ka paguar për të kompensuar palët e dëmtuara. Por, një trend krejtësisht tjetër i trajtimit të regreseve ka filluar nga viti 2020 e këndej. Vetëm në dy vitet e fundit në emër të regreseve janë kthyer në llogari të BKS-së hiç më pak se 1,2 milionë euro. Një trend më i përshpejtuar, do të vazhdojë edhe këtë vit, ku synohet një shumë e konsiderueshme e mjeteve që BKS-ja ka paguar vite më parë t'i rikthejë në llogarinë e vetë. Valon Berisha, drejtor Financiar në BKS tregon se sivjet një rëndësi të veçantë menaxhmenti i BKS-së i ka kushtuar regreseve, pra rikthimin e mjeteve që BKS-ja ka paguar kohë më parë për palët e dëmtuara.

### 450 MIJË EURO TË KTHYERA DERI NË VITIN 2020

Drejtori Berisha më tutje tregon se për këtë çështje në BKS është formuar edhe një ekip i veçantë që punë të vetme e ka këtë çështje. “Menaxhmenti paraprak për më shumë se një dekadë ka arritur të inkasoj në emër të regreseve vetëm 450 mijë euro. Vetëm në dy vitet e fundit kemi arritur të kthejmë 1.2 milionë euro. Ne jemi duke vazhduar punën në këtë drejtim me një ritëm të përshpejtuar për të trajtuar të gjitha rastet që janë të trajtueshme me ligj. Fatkeqësisht nga neglizhenca paraprake një pjesë e lëndëve tashme janë parashkruar dhe de juro në ato mjete nuk mund t'i kthejmë”, ka thënë drejtori Berisha. Më tutje Berisha tregon se sa i përket viteve të fundit BKS-ja i trajton më shume prioritet dhe kujdes regreset, pasi që synon të kthejë të gjitha mjetet që Byroja paguan për palët e dëmtuara nga qytetarët të cilët kanë shkaktuar aksident me automjet të pasiguruar.

### MJETET E KTHYERA NDËR VITE

Bazuar në të dhëna zyrtare të Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) shihet se deri në vitin 2020 në emër të regreseve janë kthyer në llogari të BKS-së vetëm 455 mijë e 12 euro. Më tutje gjithmonë duke iu referuar të dhënave zyrtare shihet se në vitin 2021 në emër të regreseve menaxhmenti i BKS-së ka arritur të kthejë 248 mijë e 26 euro. Në vitin 2022, falë punës dhe angazhimit të

madh të menaxhmentit është arritur rekord i kthimit të mjeteve në emër të regreseve. Sipas të dhënave të BKS-së shihet se gjatë vitit që lamë pas në emër të regreseve janë kthyer 751 mijë e 528 euro. Gjithashtu edhe në dy muajt e parë të vitit 2023 në emër të regreseve në llogarinë e Byrosë Kosovare janë kthyer 117 mijë euro, e derisa një shumë e konsiderueshme e mjeteve pritet të kthehet deri në fund të vitit.

### BERISHA: MOS DILNI NË KOMUNIKACION MË AUTOMJET TË PASIGURUAR

Drejtori i financave në Byronë Kosovare të Sigurimit Valon Berisha apelon të qytetarët që mos të dalin në komunikacion pa policë sigurimi, pasi që sipas tij në të ardhmen pasojat për ta do të jenë të mëdha. “Në bazë të ligjeve në fuqi BKS-ja duhet t'i kompensojë të gjitha palët e dëmtuara nga qytetarët që kanë shkaktuar aksident me automjet të pajisur, por ligji e obligon më tutje BKS-në të kthejë të gjitha mjetet që ajo ka paguar për palët e dëmtuara”, ka thënë Berisha. Sipas tij, një policë ka një çmim shumë minimal karshi mbulesës që ajo ofron për dëmet e shkaktuara deri në 1,2 milionë euro. Sipas Berishës dëmet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara edhe më tutje vazhdojnë të dëmtojnë në masë të madhe sektorin e sigurimeve, pasi që vlera e dëmeve për çdo vit është milionëshe.

### MBI 2,2 MILIONË EURO DËMET E SHKAKTUAR NGA TRAKTORËT E PAREGJISTRUAR

Shuma të konsiderueshme të mjeteve edhe më tutje vazhdojnë të shpenzohen nga Byroja Kosovare e Sigurimit për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga traktorët në gjithë Kosovën. Referuar të dhënave zyrtare që ka BKS-ja, deri më tash shuma e mjeteve që janë paguar për këtë qëllim ka kaluar 2.2 milionë euro e që paraqet një barrë shumë të madhe për Byronë Kosovare të Sigurimit. Përfaqësues të BKS-së apelojnë te fermerët që të regjistrojnë mjetet e tyre të punës, pasi që sipas tij në rast të aksidenteve pa sigurim BKS-ja kompenson palën e dëmtuar, por më pastaj të gjitha mjete rimbursohen nga shkaktari i aksidentit.

“Aksidentet e shkaktuara nga traktorët e pasiguruar janë shumë të rënda, pasi që në disa raste traktorët dalin në rrugë pa sigurim, pa shenja të sinjalistikës, pa drita...etj., e që paraqesin rrezik serioz për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion. Ne kërkojmë nga fermerët që sa më parë t'i sigurojnë traktorët e tyre, pasi që në rast të aksidentit e gjitha barra qoftë

## 455,012€

është shuma e mjeteve që Byroja Kosovare e Sigurimit ka kthyer në emër të regreseve nga viti 2012 e deri në vitin 2020.

---

## 248,026€

është shuma e mjeteve që Byroja Kosovare e Sigurimit ka kthyer në emër të regreseve në vitin 2021.

---

## 751,528€

është shuma e mjeteve që Byroja Kosovare e Sigurimit ka kthyer në emër të regreseve në vitin 2022.

---

## 117,747€

është shuma e mjeteve që Byroja Kosovare e Sigurimit ka kthyer në emër të regreseve në muajin janar e shkurt të vitit 2023.

për kompensim të demit, qoftë për trajtim të lënduarave të mundshëm bie direkt mbi ta. Në bazë të ligjit BKS-ja e kompenson palën e dëmtuar, por më pastaj të gjitha mjetet i rimburson nga shkaktari i aksidentit”, thonë përfaqësues të BKS-së. Gjithnjë bazuar në të dhënat e siguruar shihet se në një rast BKS-ja është dashur të kompensojë një shumë prej më shumë se 43 mijë euro nga aksidenti i shkaktuar nga një traktor i pasiguruar. Në një rast tjetër gjithashtu BKS-ja ka kompensuar palën e dëmtuar në shumën mbi 15 mijë euro, e në shumë raste mbi 10 mijë e nën 10 mijë euro. Në anën tjetër përfaqësues të BKS-së thonë se së fundmi janë duke u marrë në mënyrë intensive me regrese, por sipas tyre në këtë drejtim problem paraqesin edhe gjykatat të cilat në masë të madhe vonojnë trajtimin e lëndëve.

## 26,85 % rritet shitja e policave kufitare

Gjatë muajit janar të këtij viti shitja e policave kufitare është rritur për 26,85 % në raport me muajin janar të vitit që

lamë pas. Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë muajit janar të këtij

viti janë shitur 16,751 polica kufitare, nga 13,208 polica kufitare sa janë shitur gjatë muajit janar 2022.

**16,751**  
polica kufitare janë shitur gjatë muajit janar 2023.

**13,208**  
polica kufitare janë shitur gjatë muajit janar 2022.

**26.85%**  
është rritur shitja e policave kufitare gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin janar 2022.

## 779 polica për sigurim nga zjarri

Vetëm gjatë muajit të parë të këtij viti kompanitë e sigurimeve në vend kanë shitur 779 polica sigurim nga zjarri, nga 740 polica sigurim

nga zjarri janë shitur gjatë muajit janar 2022. Referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë muajit

janar të këtij viti shitja policave është më e lartë për 5,27 % në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

**779**  
polica sigurim nga zjarri janë shitur gjatë muajit janar 2023.

**740**  
polica sigurim nga zjarri janë shitur gjatë muajit janar 2022.

**5.27%**  
është rritur shitja e policave sigurim nga zjarri gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin janar 2022.

## 1,255 polica për sigurim të mjeteve tokësore

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë periudhës janar të këtij viti kompanitë e sigurimeve në vend kanë

shitur 1,255 polica për sigurim të mjeteve tokësore, nga 1,255 polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë muajit janar 2022. Nëse bëjmë një krahasim

të thjeshtë shihet se 1,46 % është rritur shitja e policave për sigurimin e mjeteve tokësore gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin janar 2022.

**1,255**  
polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë muajit janar 2023.

**1,255**  
polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë muajit janar 2022.

**1.46%**  
është rritur shitja e policave për sigurimin e mjeteve tokësore gjatë muajit janar 2023 në raport me muajin janar 2022.



## MAZREKU: STIKERSAT NDIKUAN POZITIVISHT NË SIGURINË NË TRAFIKUN RRUGOR

Nga 16 marsi 2023, asnjë automjet nëpër rrugët e Kosovës nuk duhet të jetë pa ngjitës (stikers) i cili dëshmon se automjeti në fjalë ka të kryer procesin e regjistrimit, ashtu siç parashihet me ligjet në fuqi. Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku, tha se përmes këtij projekti pritet edhe më shumë ulja e numrit të automjeteve të paregjistruara në Kosovë, që vitet e kaluara kanë qenë mbi 200 mijë automjete. “Është vërejtur shumë se ky projekt ka qenë shumë i suksesshëm. Ende pa u bërë një vit kemi vërejtur se ka pasur 10 deri në 15 % më pak aksidente, këtë vit presim që të kemi edhe më pak aksidente”, tha ai për RTK-në. Mazreku bëri me dije se zbatimi i projektit për vendosjen e ngjitëseve është mbështetur financiarisht 100 % nga kompanitë e sigurimeve që operojnë në vendin tonë. Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku, ka folur edhe për zhvillimin e sektorit të sigurimeve. “Përherë të parë kemi një sektor stabil dhe mirë të kapitalizuar. Sipas tij kjo arritje është falë përkushtimit të guvernatorit të BQK-së, Fehmi Mehmeti, dhe kompanive të sigurimeve që operojnë në Kosovë. Ai ka përmendur heqjen e barrierave që kanë dëmtuar rëndë kompanitë e sigurimeve si: Ligji për Kryqin e Kuq, Ligji për Korporata dhe së fundi

heqjen e kushtëzime të ratimit në pronë. **KJO DO TË JETË POLICA E RE KUFITARE**

Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) njofton se nga sot ka hyrë në përdorim polica kufitare, e cila mbyll ciklin e ndryshimeve të policave që janë bërë në këtë Institucion.

Në fillim BKS-ja kishte ndryshuar policën TPL, me pastaj TPL Plus dhe tash në fund është bërë dizajni i policës kufitare.

Drejtori BKS-së ka njoftuar se policat që tashmë janë në funksion janë të një standardi të lartë si në aspektin vizual, ashtu edhe në atë të sigurisë.

Mazreku ka thënë se janë duke punuar në vazhdimësi që në një të ardhme të shpejt ta eliminojnë në tersi kopjet fizike të policave.

### NGA 16 MARS, S'KA MË VETURA PA STIKERSA

Nga nesër (e enjte), 16 mars 2023, asnjë automjet nëpër rrugët e Kosovës nuk duhet të jetë pa ngjitës (stikers) i cili dëshmon se automjeti në fjalë ka të kryer procesin e regjistrimit, ashtu siç parashihet me ligjet në fuqi. Gjatë vitit të parë të zbatimit të projektit për vendosjen e ngjitëseve, i mbështetur financiarisht 100% nga kompanitë e sigurimeve që operojnë në vendin tonë rezultatet janë të dukshme. Por, efekti

do të jetë më i madh nga nesër 16.03.2023, kur asnjë veturë nëpër rrugët e Kosovës më nuk duhet të jetë pa stikers. Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, vlerëson se projekti në fjalë ka dhënë rezultate të mëdha vitin e parë, por rezultat edhe më të mëdha do të jepen sivjet. “Vitin e parë ngjitësi ka pasur ngjyrë të kuqe, këtë vit ka ngjyrë të gjelbër dhe praktikisht sot behën 1 vit, kështu që nga nesër asnjë automjetet nëpër rrugët e Kosovës nuk duhet të jetë pa ngjitës”, vlerëson drejtori Mazreku. Sipas tij, përmes këtij projekti pritet edhe më shumë ulja e numrit të automjeteve të paregjistruara në vendin tonë.

### JANË MBYLLUR RRETH 22 MIJË LËNDË

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Sami Mazreku, së bashku drejtorin Financiar Valon Berisha, por edhe me bashkëpunëtorë tjerë para rreth 30 gazetarëve të pjesës dërmuese të mediave në vend kanë prezantuar të dhëna rreth aksidenteve të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara gjatë periudhës 2012-2022. Sipas drejtori Mazreku gjatë kësaj përdudhe kohore janë mbyllur rreth 22 mijë lëndë (dëme) të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara e ku vlera e tyre ishte rreth 42 milionë euro.

# SIGURIMET NË NUMRA

**11,666,735€**

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto, në fund të muajit janar të këtij viti.

**8.15%**

është rritur tregu i sigurimeve gjatë muajit janar 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

**879,550€**

është rritur volumi i primeve të shkruara bruto gjatë muajit janar 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

**2,250**

dëme më shumë janë paguar gjatë muajit janar 2023, sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

**111,424**

ka arritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetarët në fund të muajit janar të këtij vitit 2023.

**38.68%**

është rritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetarët në fund të muajit janar 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

**14,763**

dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve, por edhe nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, vetëm gjatë muajit janar 2023.

**11,048,735€**

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës, deri në fund të muajit janar 2023.

**8.83%**

është rritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës, deri në fund të muajit janar të vitit 2023.

**618,000€**

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës, deri në fund të muajit janar 2023.

**2.59%**

është rritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës deri në fund të muajit janar të këtij viti, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

**17,387**

ka arritur numri i kontratave në sigurimin e jetës, në fund të muajit janar 2023.

**2.5%**

ka rënë numri i kontratave në sigurimin e jetës gjatë muajit janar 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

**Performanca e sektorit të sigurimeve gjatë periudhës janar 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.**